


Më
Dana

28 - 09 - 2018

NË EMËR TË POPULLIT


GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Penal gjyqtarja individuale Hakile Ilazi, me zyrtaren ligjore Ganimete Avdiu, në lëndën penale kundër të pandehurit [REDACTED] i akuzuar sipas Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2199-7/2017 të datës 09.11.2017, për veprën penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 i KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.2199-7/2017 të datës 09.11.2017, për dhënien e urdhrin ndëshkimor dënim me gjobë, gjykata me dt. 10.04.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET, kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2199-7/2017 të datës 09.11.2017, dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri [REDACTED], i lindur më [REDACTED], me vendbanim në Ferizaj rr. [REDACTED] nr. [REDACTED], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORE

Me datën 21.11.2017, në Ferizaj rr."Medellin Ollbrajt", gjatë kontrollës nga Inspektorët e Ndërtimtarisë është konstatuar se i pandehuri ka vazhduar punimet në objektin e tij duke hequr dhe dëmtuar shiritat që kanë qenë të vendosur me datë 09.11.2017 nga zyrtarët e autorizuar të Sektorit të Inspektoratit të Ndërtimtarisë të Komunës së Ferizajt për shkak të mos posedimit të lejes së ndërtimit dhe dokumentacionit ndërtimor nga organi kompetent,-

-me të cilën ka kryer veprën penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 i KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 4,7,17,21,41,46,73, të KPRK-së si dhe nenit 495, të KPPK-së:

G J Y K O N

Të pandehurin, me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mundë të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par. 3 të KPRK-së, i njëjti do ti shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

Te dëmtuarën, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mjedis në Ferizaj – sektori i ndërtimtarisë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike e udhëzon në kontest civil.

Detyrohet i pandehuri që për kompensimin e Viktimave të Krimit ta paguaj shumën prej 30 € (tridhjetë euro), brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Gjithashtu obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.2199-7/2017 të datës 09.11.2017, ka akuzuar të pandehurin [REDAKTUAR], për veprën penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 i KPRK-së, dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor PP/II.nr.2199-7/2017 të datës 09.11.2017, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1 të KPPK-së.

Gjykata pasi shqyrtoj provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës si: procesverbalet nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mjedis të datës 09.10.2017 dhe 21.10.2017, vendimi i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mjedis i datës 10.10.2017, si dhe dokumentacionet e tjera të bashkangjitura në lëndë, vërtetojnë se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqipton dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 39 par. 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Konform nenit 450 dhe 451 të KPPK-së gjithashtu obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20€, në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.


Nga arsyet e sipër cekura, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.2785/17, me datë 10.04.2018

Zyrtarja ligjore
Ganimete Avdiu

Gjyqtarja Individuale
Hakile Ilazi



KËSHILLË JURIDIKE:

Kudër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit të njëjtës gjykatë.